

Indikatorë të zgjedhur	2009	2010	2011	2012	2013
Rritja Reale e PBB (%)	3.5	3.2	4.4	2.5	3.1 (e)
PBB (mln EUR)	4007.8	4291.1	4769.8	4916.4	
Inflacioni (mesatarja vjetore)	-2.4	3.5	7.3	2.5	1.8
Kreditë (mln EUR)	1289	1458.7	1698.1	1763.4	1805.8
Depozitat (mln EUR)	1744.8	1936.9	2104	2279	2449.0
Eksportet (mln EUR)	165.3	295.9	319.2	276.1	293.9
Importet (mln EUR)	1935.5	2157.7	2492.3	2507.6	2450.4

Shënim: (e) Vlerësim, Burimi: BQK dhe ASK (2013)

Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2013 u karakterizua me trende pozitive. Rrjedhimisht, norma e rritjes ekonomike arriti në 3.1 përqind. Përmirësimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë si përmirësimi i pozicionit neto të eksporteve në mallra dhe shërbime kanë bërë që kontributi i kësaj kategorie të jetë pozitiv. Përveç pozicionit të jashtëm, edhe komponenta e konsumit ka vazhduar të mbajë trendet pozitive duke u përkrahur nga remitencat, kreditë konsumuese si dhe nga pagat. Sa i përket investimeve, trendi pozitiv i tyre u përkrah nga investimet e huaja direkte dhe kreditë për investime. Kontribut pozitiv në rritjen ekonomike kishte edhe sektori fiskal i cili u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve.

Trendet e përgjithshme të normës së ulët të inflacionit u përcollën edhe në Kosovë gjatë vitit 2013, mirëpo, në Kosovë inflacioni prej 1.8 përqind ishte më tepër i shkaktuar nga çmimet ndërkombëtare dhe jo domosdo nga kërkesa e brendshme.

Ngjarjet kryesore të tremujorit IV

Rritja reale e PBB-së për vitin 2013 vlerësohet të ketë arritur në 3.1 përqind.

Norma vjetore e inflacionit ka arritur në 1.8 përqind, e nxitur nga zhvillimet e çmimeve ndërkombëtare.

Dërgesat e emigrantëve dhe Investimet e huaja direkte deri në TM3 2013 kanë vazhduar me normat pozitive të rritjes.

Asetet e sektorit bankar kanë vazhduar të rriten. Rritjen më të madhe në kuadër të aseteve e kanë shënuar investimet në letra me vlerë, ndërkohë që kreditimi bankar, përkundër normës pozitive të rritjes, vazhdon të karakterizohet me ngadalësim të trendit të rritjes.

Tregu i bonove të thesarit vazhdoi të karakterizohet me ofertim të lartë dhe me normë të ulët të interesit, por në muajt e fundit të vitit, interesimi i akterëve për letra me vlerë është zhvendosur drejt atyre me afat më të gjatë maturimi. Sidoqoftë, të gjithë treguesit në kuadër të këtij tregu reflektojnë stabilitetin financiar dhe fiskal në Kosovë.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	i
Ekonomia globale	04
Ekonomia e Kosovës	07
Sektori Real	07
Sistemi Financiar	10
Sektori Bankar	10
Kompanitë e Sigurimit	16
Fondet Pensionale	16
Institucionet Mikrofinanciare	17
Tregu i Bonove të Thesarit	17
Sektori Fiskal	18
Sektori i Jashtëm	19
GRAFIKËT DHE TABELAT	05
Figura 1. Çmimi i naftës “brent crude”	05
Figura 2. Çmimi i arit për ounce	05
Figura 3. Çmimet e metaleve	06
Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit	06
Figura 5. Norma e këmbimit e euros	07
Figura 6. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e financimit e ECB-së	07
Figura 7. Rritja reale e PBB-së	07
Figura 8. Indeksi i çmimeve të Konsumit	08
Figura 9. Regjistri i bizneseve	09
Figura 10. Struktura e ndërmarrjeve të reja	09
Figura 11. Asetet e bankave komerciale	10
Figura 12. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave	10
Figura 13. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive	10
Figura 14. Struktura e maturimit të kredive	11
Figura 15. Kreditë sipas sektorëve ekonomik	11
Figura 16. Trendi i rritjes së kredive	12
Figura 17. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale	12
Figura 18. Strukturat e depozitave në bankat komerciale	12

Figura 19. Trendi i rritjes së depozitave -----	13
Figura 20. Mesatarja kuartale e normave të interesit -----	13
Figura 21. Normat mesatare kuartale të interesit për kreditë e ndërmarrjeve -----	13
Figura 22. Normat mesatare kuartale të interesit për kreditë e ekonomive familjare -----	14
Figura 23. Normat mesatare kuartale të interesit për depozita -----	14
Figura 24. Treguesit e profitabilitetit -----	14
Figura 25. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale -----	15
Figura 26. NPL-të dhe provizionet për humbje nga kreditë -----	15
Figura 27. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive jo-performuese -----	16
Figura 28. Asetet e institucioneve mikrofinanciare -----	17
Figura 29. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë -----	17
Figura 30. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar -----	19
Figura 31. Remitencat -----	20
Figura 32. Struktura e investimeve të huaja direkte -----	20
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	20

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl. Swiss Franc: CHF</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>)
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit (<i>angl. Index Price Index: IPI</i>)
NPL	Kredive Jopërformuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>)
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>)
USD	Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>)
WEO	World Economic Outlook

Ekonomia Globale

Rritja në ekonominë globale gjatë vitit 2013 ishte pozitive por në nivel më të ulët në krahasim me vitin paraprak. Përkundër stabilizimit të rritjes në vendet e zhvilluara, rritja më e ulët se që është pritur në vendet në zhvillim rezultoi norma e rritjes në nivel global të arrijë në 3.0 përqind krahasuar me 3.1 përqind në vitin 2012. Nga vendet në zhvillim, ishin kryesisht vendet si Kina dhe India që kishin rritje më të ngadalshme se në vitin 2012, ndërsa vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore u rritën me normë të përsheptuar. Projektionet për vitin 2014 janë mjaft inkurajuese pasi që rritja globale pritet të arrijë në 3.7 përqind, ndërsa kjo rritje pritet të jetë e balancuar në mes të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim. (IMF WOE, 2014).

Vendet e eurozonës edhe gjatë vitit 2013 e përmbyllën vitin me rritje negative prej 0.4 përqind, por se në pjesën e dytë të vitit, janë raportuar shenjat e rikuperimit. Vendet evropiane në të cilat diaspora kosovare është e koncentruar, për vitin 2014, pritet të kenë rritje ekonomike pozitive. Për shembull, rritja në vendet si Gjermania dhe Zvicra pritet të jetë 1.4 përkatësisht 1.8 përqind kundrejt rritjes prej 0.7 dhe 1.7 në vitin paraprak.

Rënia e aktivitetit ekonomik që karakterizoi eurozonën gjatë vitit 2013 dhe rritja e papunësisë ndikuan në zvogëlimin e shpenzimeve të konsumit dhe si pasojë, në rënien e vazhdueshme të çmimeve. Sipas Bankës Qendrore Evropiane, pritjet janë se çmimet gjatë vitit 2014 do të rriten me 1.5 përqind, duke ulur deri në një masë shqetësimet e ngritura për

deflacion të mundshëm. Norma vjetore e inflacionit në eurozonë në vitin 2013 ishte 1.4 përqind (2.5 përqind në vitin 2012), që njëherësiht paraqet normën më të ulët të inflacionit të shënuar në eurozonë që nga viti 2009.

Vendet e rajonit të Evropës Juglindore (EJL) në përgjithësi u karakterizuan me rritje pozitive ekonomike: Maqedonia me 2.2%, Mal i Zi me 1.5% Shqipëria me 1.7% dhe Serbia me 2.0%, ndërsa Bosnja e Hercegovina, edhe pse doli nga recesioni, u karakterizua me rritje marginale prej 0.5%. Kroacia në anën tjetër vazhdoi për të tretin vit me radhë të ballafaqohet me recesion prej 0.6% (IMF WOE, 2013). Viti 2014 pritet të jetë vit i rikuperimit të konsiderueshëm për të gjitha vendet e rajonit, ku edhe në këtë vit, Kosova pritet të ketë normën më të lartë të rritjes ekonomike.

Rritja ekonomike globale më e ulët se projektionet e mëhershme si rezultat i kërkesës më të dobët në vendet në zhvillim; kërkesa më e dobët dhe stabiliteti i ofertës kanë ndikuar që çmimet të jenë me trend rënës për shumicën e produkteve në nivel ndërkombëtar duke rezultuar në inflacion të moderuar. Për të evituar deflacionin, eurozona ka ulur normën bazë të interesit në nivelin më të ulët historik.


Çmimet e naftës (brent crude)¹ në periudhën janar-dhjetor 2013 shënuan rënie për 4.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 1). Çmimet më të ulëta të naftës gjatë vitit 2013 ishin si rezultat i rritjes së prodhimit në SHBA gjë që ndikoi

¹ 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

që kërkesa e SHBA-së për import të naftës të jetë më e ulët. Edhe stabilizimi politik në disa vende prodhuese të naftës në Lindjen së Mesme ka reflektuar në rënie të rrezikut nga ana e ofertës për naftën gjë që ndikoi në çmime më të ulëta.

Çmimet e naftës pritet të jenë relativisht stabile ose me tendencë rënëse nga 5 deri në 10 përqind gjatë vitit 2014 si rezultat i rritjes së rezervave për absorbim të goditjeve nga ana e ofertës në vendet e zhvilluara. Përveç kësaj, gjatë vitit 2014 mund të ketë vështirësi në arritjen e marrëveshjes për zvogëlim të ofertës nga organizata e shteteve eksportuese të naftës, OPEC (*angl. Organization of Petroleum Exporting Countries*) që zakonisht bëhet me qëllim të rritjes së çmimit (Bloomberg, 2014). Këto vështirësi në shtrëngim të ofertës pritet të vijnë si rezultat i nevojave më të mëdha të disa vendeve të po sa dalura nga trazirat si Libia dhe Iraku për eksport, por edhe mundësisë së lirimit nga sanksionet ndërkombëtare të Iranit.

Figura 1. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD




Burimi: Bloomberg (2014) dhe kalkulime të BQK-së

Stabiliteti ose rënia e çmimeve të naftës pritet të reflektojë edhe në stabilitet të çmimeve të mallrave të konsumit, sidomos atyre ushqimore pasi që nafta dhe

energja janë komponentë mjaft e rëndësishme në procesin e prodhimit dhe transportimit të tyre. Efektet e çmimeve të naftës gjatë vitit 2014 pritet të reflektohen pozitivisht edhe në normat e rritjes ekonomike për vendet importuese si rezultat i ngushtimit të deficitit të llogarive.

Si rezultat i stabilitetit të çmimeve në nivel global, çmimet e arit kanë shënuar rënie pasi që nuk është parë e nevojshme nga investitorët që të jetë masë mbrojtëse nga asetet tjera. Përveç kësaj, edhe problemet e borxhit në disa vende të eurozonës që ishin prezente gjatë vitit paraprak kanë ndikuar që të krijohen pritjet se oferta për metalin e arit do të rritet si mënyrë për pagesë të borxhit gjë që ka ndikuar edhe në rënie të çmimit prej më shumë se 15 përqind gjatë vitit, por rënie kjo që është ngadalsuar gradualisht.

Figura 2. Çmimi i arit për ounce




Burimi: Bloomberg dhe kalkulime të BQK-së (2014)

Metalet tjera kanë pasur lëvizje të ngjashme në krahasim me vitin paraprak, duke u karakterizuar me rënie të lehta. Përjashtim bënë këtu çmimi i aluminit i cili ka pasur rënie të konsiderueshme prej 13 përqind si rezultat i ofertës së lartë në nivel global. Edhe zinku ka pasur rënie prej 3.5 përqind për shkak

të ofertës së lartë, por rënia ishte më e moderuar si rezultat i rritjes së kërkesës në disa vende në zhvillim. Ndërsa çmimi i plumbit ka mbetur në nivel të ngjashëm si rezultat i rikuperimit të industrisë automobilistike në nivel global (figura 3), (ABN-AMRO, 2013).

Projeksione të ndryshme sygjerojnë se çmimet e metaleve kryesore pritet të jenë relativisht stabile gjatë vitit 2014 si rezultat i rritjes së kërkesës dhe investimeve në nivel global. Sidoqoftë, përjashtim këtu është metali i arit i cili si rezultat i performancës së mirë ekonomike në nivel global pritet të shënojë rënie të mëtutjeshme në çmim marrë parasysh mungesën e kërkesës si rezultat i nevojës më të ulët për mbrojtje nga ndonjë goditje negative ekonomike.

Figura 3. Çmimet e metaleve, në USD për ton




Burimi: Bloomberg dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

Mallrat ushqimore janë karakterizuar me rënie të lehtë të nxitur nga kategoria e drithërave. Indeksi i çmimeve të ushqimit në nivel global ka shënuar rënie për 1.6 përqind në krahasim me vitin paraprak, ndërsa kategoria e drithërave që shënoi rënie për 7.2 përqind ishte bartës në rënien e përgjithshme të indeksit (figura 4).

Rënia e çmimeve të produkteve ushqimore ndikohet në masë të madhe nga zhvillimet nga ana e ofertës. Gjatë vitit 2013, oferta për produkte ushqimore në nivel global është konsideruar si mjaft stabile si rrjedhojë e kushteve adekuate atmosferike në vendet prodhuese duke siguruar rendiment stabil. Në anën tjetër, përveç stabilitetit të ofertës ishte edhe rënia e çmimeve të energjisë dhe naftës që ka zvogëluar koston e prodhimit të shumicës së produkteve ushqimore.


Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAOUN (2014)

Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore është rikuperuar gjatë vitit 2013 duke iu rikthyer stabilitetit pas problemeve të vitit paraprak. Në këtë kontekst, norma e këmbimit e euros kundrejt frankut zvicerian ishte 1.23 ndërsa 0.85 kundrejt funtës britanike. Euro u ngrit në masë të konsiderueshme edhe ndaj dollarit amerikan duke arritur në 1.33.


Figura 5. Norma e këmbimit e Euros



Burimi: BQK (2014)

Që nga ndryshimi i fundit në maj të vitit 2013 norma bazë e rifinancimit e Bankës Qendrore Evropiane mbeti e pandryshuar deri në nëntor 2013. Që nga 7 nëntori 2013, norma bazë e rifinancimit u zvogëlu në nivelin më të ulët historik duke arritur në vetëm 0.25 përqind, që njëherësh paraqet nivelin më të ulët të mundshëm.

Figura 6. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor dhe ECB (2014)

Arsye për ndryshimet në normë bazë të interesit konsiderohet të jetë rënia e vazhdueshme e normës së inflacionit në eurozonë, prandaj, nëpërmjet lehtësimit të financimit për banka, përveç stimulimit të aktivitetit ekonomik, ECB ka ndërmarrë masa të

evitojë rënien e çmimeve të cilat janë në drejtim të normave negative ose deflacion.


Normat e interesit të kreditimit ndërbankar gjatë TM4 2013 u karakterizuan me ndryshime të lehta. Në TM4 2013 normat 1-mujore shënuan rritje në krahasim me periudhën paraprake nga mesatarisht 0.13 në 0.16 përqind, ndërsa normat për periudhë 12-mujore u karakterizuan me rënie të lehtë nga mesatarisht 0.54 në 0.53 përqind.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Zhvillimet në treguesit kryesor makroekonomik tregojnë për aktivitet të përshpejtuar gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012. Rrjedhimisht, vlerësimet e BQK-së janë se rritja reale ekonomike ka arritur normën prej 3.1 përqind (figura 7).

Figura 7. Rritja Reale e PBB-së, në përqindje



Burimi: ASK, (e) BQK (2014)

Për dallim nga vitet paraprake, gjatë vitit 2013, janë përmirësimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë që japin indikacione mbi përforcimin e aktivitetit ekonomik në vend. Kjo pasi që, të dhënat tregojnë për ngushtim të deficitit tregtar në mallra, që tregon për trend në zëvendësim të mallrave të importeve me ato vendore.


Komponentat tjera të PBB-së gjithashtu kanë vazhduar të kenë norma pozitive të rritjes, por efekti i tyre në rritjen ekonomike ka mbetur më i limituar. Rrjedhimisht, burimet e financimit të konsumit si dërgesat e emigrantëve, kreditë e reja konsumuese, pagat etj. kanë pasur performancë pozitive duke siguruar rritje në këtë komponentë. Edhe sa i përket

investimeve, burimet e financimit si investimet e huaja direkte (IHD), kreditë e reja investive kanë shënuar norma pozitive të rritjes. Këto komponenta të investimeve u ndikuan nga rënia e lehtë e investimeve publike, por se trendi mbeti pozitiv.

Ekonomia e Kosovës me rritjen më të lartë në rajon; edhe gjatë vitit 2014, rritja pritet të jetë e përshpejtuar. Sektori i jashtëm i ekonomisë pritet të jetë me kontribut pozitiv në rritje ekonomike si rezultat i çmimeve të favorshme të naftës dhe karburanteve tjera. Ky kontribut pritet të vijë nëpërmjet përmirësimit të bilancit të llogarisë rrjedhëse.

Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), gjatë vitit 2013 u karakterizua me rritje më të ngadalshme se në vitin paraprak. Rrjedhimisht, norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2013 ishte 1.8 përqind krahasuar me normën prej 2.5 përqind në vitin 2012 (figura 8). Presionet inflacioniste kanë qenë më të larta në TM1 2013, ndërsa gjatë pjesës tjetër të vitit, këto presione janë zbutur, sidomos në TM4 2013. Sa i përket komponentëve të CPI-së, rritje e çmimeve gjatë vitit 2013 u shënuar tek pijet alkoolike dhe duhani me 7.2 përqind (7.5 përqind në vitin 2012), veshmbathja me 2.9 përqind (2.5 përqind në vitin 2012), rekreacioni dhe kultura me 2.7 përqind (4.6 përqind në vitin 2012), ushqimi dhe pijet joalkoolike me 2.1 përqind (1.0 përqind në vitin 2012), etj., ndërsa rënie e çmimeve u shënuar tek transporti me 1.9 përqind (3.8 përqind rritje në vitin 2012) dhe mjetet e komunikimit me 0.9 përqind (4.0 përqind rënie në vitin 2012).


Figura 8. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2014)

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë vazhdojnë të jenë mjaft të ngjashme me zhvillimet globale si pasojë e mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe, dhe rrjedhimisht niveli i përgjithshëm i çmimeve në vend është i ndikuar nga lëvizja e çmimeve të mallrave të importuara, pasi që rënia e çmimeve të mallrave kryesore, si nafta, ndikon edhe në koston e prodhimit në Kosovë. Kjo konfirmohet deri diku edhe nëpërmjet indeksit të çmimeve të importit (angl: Import Price Index: IPI). IPI-ja deri në shtator 2013 është rritur për 0.6 përqind, dhe siç është paraqitur në figurën 8, edhe CPI-ja ka treguar sjellje të ngjashmë me IPI-në. Ndërsa, çmimet e prodhimit deri në shator 2013 u karakterizuan me rritje vjetore prej 3.3 përqind, rritje kjo e cila u nxit nga rritja e çmimeve të nxjerrjes së qymyrgurit, linjitit, mineraleve dhe produkteve të industrive tjera nxjerrëse.


Figura 9. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2013)

Gjatë TM4 2013, në Kosovë u regjistruan 1805 biznese të reja ndërsa, ndërsa u mbyllën 404 biznese. Gjatë periudhës janar–dhjetor 2013 numri i gjithsej bizneseve të reja që u hapën ishte 9421, apo 171 biznese më pak se në vitin e kaluar. Gjithsej numri i bizneseve të mbyllura arriti në 1508, apo 427 më shumë se në vitin paraprak. Sidoqoftë, marrë parasysh nivelin e lartë të regjistrimeve të reja në dy vitet e fundit, është e pritur që numri i bizneseve të mbyllura të rritet. Si përqindje, bizneset e mbyllura kundrejt atyre të hapura janë nën nivelin e vitit 2010 që kishte normën më të lartë. Në krahasim me vendet tjera, të dhënat mbi bizneset e regjistruara vazhdojnë të jenë inkurajuese në Kosovë marrë parasysh se mbyllja e bizneseve ende ka raportin në 1 ose 2 në 10 biznese që mbyllet, ndërsa vendet tjera ballafaqohen me mbi 3 nga 10 biznese që mbyllet brenda vitit të parë. Ky raport mund të rritet edhe në Kosovë por përderisa nuk tejkalon mesataren e vendeve tjera, nuk paraqet rrezik mbi aktiviteti ekonomik në vend.

Figura 10. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2014)

Trendet sa i përket strukturës së ndërmarrjeve kanë vazhduar të jenë të ngjashme me periudhat paraprake të këtij viti, por se ky vit është karakterizuar me përshpejtim të rritjes së bizneseve të reja në bujqësi (figura 10) dhe patundshmëri, ndërsa tregtia ka mbajtur nivelin e ngjashëm me vitet paraprake. Këto të dhëna janë konsistente me të dhënat e kreditimit sipas industrive, ku vërehet se është rritur përkrahja e sistemit bankar ndaj bujqësisë, patundshmërisë dhe hotelërisë, ndërsa, ndaj tregtisë ka mbajtur nivel të ngjashëm me vitin paraprak por është zvogëluar kreditimi ndaj sektorit të ndërtimitarisë dhe prodhimit. Bujqësia si një nga industritë me trende pozitive gjatë këtij viti ka pasur përkrahje më të madhe edhe nga qeveria nëpërmjet subvencioneve dhe transfereve.


Sistemi Financiar

Sektori Bankar

Asetet

Sektori bankar në Kosovë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2013 u karakterizua me zhvillime pozitive. Asetet e bankave komerciale arritën vlerën prej 3.06 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8 përqind (6.8 përqind në 2012), (figura 11).

Figura 11. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore




Burimi: BQK (2014)

Rritja kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar të investimeve në letrat me vlerë dhe rezervave të mbajtura në BQK. Për dallim nga tremujorët paraprak për herë të parë në TM4 2013, investimet në letrat me vlerë, tejkaluan në vlerë rezervat e mbajtura në BQK. Investimet arritën vlerën 354.5 milion euro, duke shënuar rritje vjetore prej 38 përqind (27 përqind në 2012). Ky zhvillim reflekton orientimin e bankave në drejtim të instrumenteve afatgjata që kanë kthim më të lartë. Ndërsa, bilanci i bankave komerciale në BQK arriti vlerën prej 331.8 milion euro që paraqet një rritje vjetore prej 10 përqind (37 përqind në 2012).

Kreditë


Figura 12. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Aktiviteti kreditues, ka vazhduar të rritet edhe në TM4 2013 por me ritëm të ngadalsuar në krahasim me vitin paraprak. Në dhjetor 2013, gjithsej kreditë shënuan vlerën prej 1.81 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.4 përqind (3.9 përqind në 2012). (figura 12).

Figura 13. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive



Burimi: BQK (2014)


Pjesa më e madhe e kredive vazhdon të përfaqësohet nga kreditë e lëshuara për ndërmarrjet të cilat përbëjnë 67 përqind të gjithsej kredive.

Në pjesën e mbetur hyjnë kreditë për ekonomitë familjare me pjesëmarrje prej 31 përqind dhe kreditë tjera (jo-rezidentëve, në jo-euro etj.) me 2 përqind.

Derisa kreditë për ndërmarrje në TM4 2013 shënuan rritje vjetore prej 2 përqind (4 përqind në 2012), kreditë për ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje vjetore për 4 përqind (6.2 përqind në 2012). Këto zhvillime tregojnë se ngadalësimi i kredidhënies që në vitet paraprake kishte prekur më tepër ndërmarrjet, gjatë vitit 2013 ka filluar të vërehet në masë më të theksuar edhe te ekonomitë familjare.

Zhvillimet pozitive të sektorit bankar janë kryesisht rezultat i rritjes më të theksuar të investimeve në letra në vlerë dhe rezervave në BQK. Kontribues modest në këto zhvillime ishte edhe aktiviteti kreditues i cili u karakterizua me rritje më të ngadalshme në krahasim me vitin paraprak.

Figura 14. Struktura e maturimit të kredive




Burimi: BQK (2014)

Nga aspekti i strukturës së maturimit, vazhdojnë të dominojnë kreditë me afat të gjatë maturimi ‘mbi dy vite’, të cilat në TM4 2013 përbënin 67 përqind të gjithsej kredive (71 përqind në 2012).

Pjesëmarrje të konsiderueshme kanë edhe kredi të me maturitet ‘deri në një vit’ të cilat në TM4 2013 arritën në 25 përqind (21 përqind në 2012). Kreditë me maturitet ‘mbi një vit deri në dy vite’ arritën pjesëmarrjen deri në 7.7 përqind në TM4 2013. (figura 14). Rjedhimisht, vërehet një zhvendosje e lehtë e kredive me afat më të gjatë maturimi drejt kredive me afat më të shkurtër maturimi. Kjo është një karakteristikë e tregut të kredive për të katërtin vit radhazi që reflekton perceptimet e bankave për rrezik më të ulët në këtë kategori.

Sipas sektorëve të veçantë ekonomik, edhe në TM4 2013 shumica e kreditimit ishte drejtuar sektorit të tregtisë, që përfshin 52.6 përqind të gjithsej kredive.

Figura 15. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Ngadalësimi i kreditimit të sektorit bankar u reflektua më shumë në kreditë për sektorët e ndërtimtarisë dhe të prodhimtarisë. Kreditë për ndërtimtari shënuan rënie vjetore prej 5.2 përqind përderisa kreditë për prodhimtarinë u karakterizuan me rënie vjetore prej 1 përqind. Sektorët që shënuan rritje në TM4 2013 ishin tregtia, bujqësia dhe shërbimet tjera financiare. Kreditë për tregti u karakterizuan me rritje vjetore prej 1 përqind e cila

ishite dukshëm më e ulët në krahasim me vitin paraprak (4.8 përqind në 2012). Kreditimi i sektorit të bujqësisë shënoi rritje vjetore prej 5 përqind krahasuar me TM4 2012 ku kishte rritje vjetore prej 7.7 përqind. Edhe pse kreditë për shërbime financiare (patundshmëri, qera, etj.) përfaqësojnë vetëm 5.6 përqind të kredive u karakterizuan me një rritje vjetore prej 26.2 përqind.

Nëse analizohet zhvillimi kuartal, kreditë në TM4 2013 u karakterizuan me rritje prej 0.4 përqind krahasuar me TM3 2013 (ku u shënuua zvogëlim prej 1.5 përqind). Faktorët kryesor që kontribuan në rritje ishin rritja e kredive për korporata tjera financiare (8.6 përqind) dhe e kredive për ekonomitë familjare (1.3 përqind).

Figura 16. Trendi i rritjes së kredive, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Megjithate, rritja e kredive gjatë tremujorit të katërt, mes tjerash, reflekton edhe efektin e sezonalitetit. Bazuar në figurën 15, vërehet se edhe në vitet paraprake tremujori i katërt është karakterizuar me nivel më të lartë të kredive krahasuar me tremujorët paraprak.

Depozitat


Figura 17. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale



Burimi: BQK (2014)

Gjatë tremujorit të katërt të 2013, gjithsej depozitat në sistemin bankar arritën vlerën 2.4 miliardë euro duke shënuar rritje vjetore prej 7.5 përqind (8.3 përqind në 2012) (figura 16).

Figura 18. Struktura e depozitave në bankat komerciale




Burimi: BQK (2014)

Kontribues kryesor në rritjen e depozitave, vazhduan të jenë depozitat e ekonomive familjare që përfaqësojnë 72 përqind të gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës (figura 18) të cilat shënuan rritje vjetore prej 8 përqind.

Depozitat e ndërmarrjeve private (që përfaqësojnë 16 përqind të gjithsej depozitave) u karakterizuan me rritje vjetore prej 18.5 përqind në dhjetor 2013 (16.6 përqind në 2012). Ky trend i rritjes së depozitave reflekton besimin në sistemin bankar në vend.

Figura 19. Trendi i rritjes së depozitave, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


Trendi i zhvillimit kuartal tregon që depozitat në TM4 2013 u karakterizuan me rritje prej 4.5 përqind krahasuar me TM3 2013. Mirëpo kjo rritje, mes tjerash, reflekton efektin e sezonalitetit. (figurën 19).

Normat e Interesit

Në tremujorin e katërt të vitit 2013, norma efektive e interesit në kredi u zvogëluar në 11.6 përqind krahasuar me 12.9 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 20).

Trendi i zhvillimit kuartal të normave mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve tregon se norma mesatare e interesit për kreditë investuese ka shënuar rënie të lehtë (nga 12 përqind në TM3 në 11.7 përqind në TM4), ndërsa për kreditë tjera biznesore norma e interesit ka mbet relativisht e njëjtë (figura 21).


Figura 20. Mesatarja kuartale e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Kjo rënie e normave të interesit për kreditë investuese ishte nxitur nga rënia e interesit në kreditë me maturim prej një deri në pesë vite, ndërsa rritja e normave të interesit për kreditë tjera biznesore ishte si rezultat i rritjes së kredive me maturim mbi pesë vit.

Figura 21. Normat mesatare kuartale të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Sa i përket kredive për ekonomitë familjare trendi i zhvillimit kuartal tregon që norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese karakterizohet me një rënie të lehtë (12 përqind në TM4 2013 krahasuar me 13.2 përqind në TM4 2012). Ndërsa normat mesatare të interesit për kreditë për blerje të shtëpive

kanë shënuar një ngritje të lehtë (10.5 përqind në TM4 2013 nga 10.3 përqind në TM4 2012) (figura 22).


Figura 22. Normat mesatare kuartale të interesit për kreditë e ekonomive familjare, në përqind



Burimi: BQK (2014)

Rënia e vazhdueshme e normave të interesit në kreditë bankare është reflektuar në ngushtimin e dallimit ndërmjet normës së interesit në kredi dhe depozita. Në TM4 2013, ky dallim u zvogëluar në 8.7 përqind, krahasuar me 9.2 përqind në TM4 2012.

Figura 23. Normat mesatare kuartale të interesit për depozita, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Norma mesatare e interesit në depozita në TM4 2013 u zvogëluar në 2.98 përqind, nga 3.73 përqind sa ishte në TM4 2012. Kjo rënie kryesisht i atribuohet zvogëlimit të normave mesatare të interesit si në


depozitat e ndërmarrjeve (rënie më të theksuar) ashtu edhe në depozitat e ekonomive familjare.

Në përgjithësi normat efektive të interesit në kredi dhe depozita në TM4 2013 janë zvogëluar në krahasim me vitin paraprak. Gjithësesi rënia e normës së interesit në kredi ishte dukshëm më e theksuar dhe kjo është reflektuar në ngushtimin e dallimit ndërmjet normave të interesit të kredive dhe depozitave.

Asetet e Jashtme Neto

Asetet e Jashtme Neto të bankave komerciale në TM4 2013 shënuan rritje vjetore prej 16.8 përqind. Kërkesa ndaj jorezidentëve shënoi rritje vjetore prej 18 përqind. Pjesën më të madhe të kërkesës ndaj jorezidentëve e përbëjnë letrat me vlerë, depozitat si dhe kreditë. Ndërsa, detyrimet ndaj jorezidentëve u karakterizuan me rritje vjetore prej 25.5 përqind. Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm kryesisht përbëhen nga depozitat e jorezidentëve dhe kreditë pjesën më të madhe të të cilave bankat komerciale në Kosovë i kanë huazuar nga bankat amë.

Figura 24. Treguesit e profitabilitetit



*Profiti i anualizuar i tremujorit të tretë
Burimi: BQK (2014)


Sektori bankar u karakterizua me performancë pozitive gjatë TM4 të vitit 2013, ku fitimi neto arriti

vlerën prej 26.6 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 44 përqind krahasuar me TM4 2012.

Sa i përket indikatorëve tjerë të performancës: norma e Kthimit në Mesataren e Aseteve (ROAA) u përmirësua në 0.9 përqind, nga 0.7 përqind në TM4 2012. Norma e Kthimit në Mesataren e Kapitalit (ROAE) në TM4 2013 u përmirësua në 9.6 përqind, nga 7.1 përqind në TM4 2012 (figura 24). Këto zhvillime reflektojnë menaxhim më efikas të aseteve dhe kapitalit krahasuar me vitin paraprak.

Gjatë TM4 2013 të hyrat e sektorit bankar kanë shënuar rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, dhe gjithsej shpenzimet kanë rënë. Këto lëvizje janë reflektuar edhe në indikatorin e efikasitetit që matë raportin e shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit bankar. Në TM4 2013, ky indikator ishte 88.5 përqind, që tregon përmirësim të efikasitetit krahasuar me vitin paraprak (90.9 përqind në TM4 2012) (figura 25).

Figura 25. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale



Burimi: BQK (2014)


Rritja e të hyrave është kryesisht rezultat i rritjes së të hyrave nga jo-interesi që shënuan rritje vjetore prej 6.44 përqind për dallim nga rënia vjetore prej 1.11

përqind e të hyrave nga interesi. Ndërsa në rënie e shpenzimeve kontribuesi kryesor janë shpenzimet e jo-interesit të cilat shënuan rënie vjetore prej 7.3 përqind në krahasim me TM4 2012. Në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit lëvizjen kryesore patën shpenzimet për provizione të cilat u zvogëluan për 9.6% në krahasim me vitin paraprak.

Në TM4 2013 të hyrat e sektorit bankar shënuan rritje, ndërsa shpenzimet shënuan rënie krahasuar me vitin paraprak. Këto zhvillime sygjerojnë menaxhim me efikas të bankave në krahasim me vitin paraprak.

Gjatë TM4 të vitit 2013 pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kredite ka arritur në 8.7 përqind krahasuar me 7.5 përqind në TM4 2012. (figura 26).

Figura 26. NPL dhe provizionet për humbje nga kredite




Burimi: BQK (2014)

Gjithësesi kjo rritje kryesisht mund të reflektoj shtrëngimin e kreditimit nga bankat komerciale (figura 27).

Kredite joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbjet e mundshme nga kredite. Në TM4 2013, mbulueshmëria e kredive

joperformuese me provizione për humbje nga kredite është 110.5% përqind (112.6 përqind në 2012).

Figura 27. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Sektori bankar ka përforcuar nivelin e kapitalit gjatë TM4 2013 ku treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 16.7 përqind nga 14.2 përqind sa ishte në TM4 2012. Përforcimi i atribuohet kryesisht përmirësimit të performancës së sektorit bankar në sajë të rritjes së profitit si dhe rritjes së kapitalit nga aksionarët si rezultat i kërkesave të reja të rregullatorit.

Gjithashtu, gjatë TM4 2013 sektori bankar vijoi të mbajë nivel të lartë të likuiditetit. Raporti i kredive ndaj depozitave në TM4 2013 u zvogëlua në 73.7 përqind, nga 77.3 përqind në TM4 2012. Gjithashtu raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve të sektorit, si dhe ndaj detyrimeve afatshkurtra qëndron në nivel të lartë. Në dhjetor 2013, asetet likuide themelore përbënin 25.2 përqind të gjithsej aseteve (25.3% në 2012), ndërsa raporti i mjeteve likuide 'gjithëpërfshirëse' ndaj gjithsej aseteve u ngrit në 34.0 përqind krahasuar me 32.6 përqind në vitin paraprak. Me rregullativë të BQK-së kërkohet që niveli minimal

i raportit të mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të jetë 25 përqind. Në TM4 2013 për sektorin bankar ky raport është 43.4 përqind duke tejkaluar dukshëm kërkesën rregullative.

Kompanitë e sigurimit

Në TM4 2013, gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në Kosovë arritën në 132 milion euro (119 milionë euro jo-jetë dhe 13 milion euro jetë), duke shënuar rritje vjetore prej 1.41 përqind. Vlera e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe arriti në 79 milion euro (77 milion euro jo-jetë dhe 2 milion euro jetë) që krahasuar me TM4 2012, paraqet një rritje vjetore prej 11.8 përqind. Me rritje vjetore prej 24 përqind u karakterizuan gjithsej dëmet e paguara të sektorit, që në TM4 2013 arritën vlerën prej afro 38.5 milion euro (31 milion euro në TM4 2012). Sektori i sigurimeve u karakterizua me humbje në vlerë prej 337 mijë euro (jo-jetë humbje 624 mijë euro dhe jetë profit prej 287 mijë euro) në TM4 2013. Gjithësesi kjo ishte humbje dukshëm më e vogël në krahasim me atë prej 3.1 milion euro në TM4 2012.

Fondet pensionale

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës vazhdoi trendin e rritjes së asetëve dhe kthimit neto nga investimet edhe në tremujorin e fundit të vitit 2013. Totali i asetëve pensionale nën menaxhimin e Trustit arriti vlerën prej 913.1 milionë euro në dhjetor 2013, që paraqet rritje vjetore prej 23.4 përqind. Kthimi bruto nga investimet në dhjetor 2013 arriti në 71 milionë euro, që në vlerë nominale paraqet kthimin më të lartë të realizuar gjatë operimit të tij. Çmimi i aksionit në TM4 shënoi rritje vjetore prej 8.5 përqind


krahasuar me 6.4 përqind në TM3, duke arritur në 1.21 euro në fund të vitit 2013 (1.17 euro në TM3 2012).

Institucionet mikrofinanciare

Vlera nominale e asetëve të institucioneve mikrofinanciare në dhjetor 2013 arriti në 113.2 milion euro, duke ndikuar që rënia vjetore në TM4 të zbris në 2.3 përqind krahasuar me rënien 7.5 përqind në TM4 2012.

Rënia vjetore e asetëve i atribuohet kryesisht aktivitetit më të ngadalshëm kreditor. Në dhjetor 2013, gjithsej kreditë dhe lizingjet e IMF-ve shënuan rënie vjetore prej 4 përqind. Rënie vjetore më të theksuar e shënuan kreditë për biznese prej 17.4 përqind, pasuar nga kreditë për ekonomitë familjare me 0.6 përqind. Lizingjet, në anën tjetër, vazhduan rritjen ku në dhjetor 2013 shënuan normë vjetore të rritjes prej 6 përqind.

Figura 28. Asetet e institucioneve mikrofinanciare (ndryshimet tremujore)



Burimi: BQQ (2014)

Mesatarja e normës efektive të interesit për kredi të reja të lëshuara nga IMF-të në vitin 2013 shënoi rënie në 23.2 përqind nga 23.5 përqind në vitin 2012. Të


hyrat e sektorit gjithashtu shënuan rënie. Në dhjetor 2013, sektori realizoi të hyra prej 19.1 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 8 përqind në krahasim vitin paraprak (20.8 milionë euro në 2012). Sidoqoftë, shpenzimet gjatë vitit 2013 shënuan rënie vjetore më të theksuar prej 23 përqind, duke ndikuar që sektori të ngushtojë humbjen në 0.3 milionë euro krahasuar me 4.5 milionë në TM4 2012.

Gjatë TM4 2013 Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës vazhdoi të shënoj rritje të aseteve dhe kthim pozitiv neto të investimeve. Ndërsa sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar arritën të zvogëlojnë rënie vjetore dukshëm në krahasim me vitin paraprak.

Tregu i Bonove të Thesarit

Deri në dhjetor 2013, kalendari i publikuar për letra me vlerë ka qenë i paraparë të ketë 12 ankande me afat maturimi 91 ditë, 7 ankande për periudhë maturimi 182 ditë dhe 2 për afat maturimi 364 ditë.

Figura 29. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë, në milionë euro



Vërejtje: Ankandet janë për shumata e ofertuara për 91 ditë.
Burimi: BQK (2014)

Mirëpo, si rezultat i ofertimit të ulët në instrumentet afatshkurtra, Departamenti i Thesarit ka ndryshuar afatin e maturimit për ankandin e dhjetorit nga 91

ditë në 364 ditë. Kjo si rezultat i ofertimit më të lartë të bankave për instrumentet me afat më të gjatë.

Për dallim nga periudhat paraprake, në ofertim nga akterët primar ka pasur ndryshim duke u vërejtur një lëvizje nga letrat me vlerë 3 mujore në drejtim të atyre më afatgjata. Rrjedhimisht, në ofertimet tremujore ka pasur rënie substanciale në tetor dhe nëntorë ku akterët primar mbuluan 97 përkatësisht 62 përqind të kërkesës së Departamentit të Thesarit për letra me vlerë.

Përkundër ofertimit relativisht të ulët për letra me vlerë tremujore, norma e interesit mbeti e ulët në 0.5 përqind. Në anën tjetër, ofertimi nga akterët primar për ankandet me afat maturimi 182 ditë është rritur kundrejt rënies për letrat me vlerë 91 ditëshe. Rrjedhimisht, ofertimi vazhdimisht ka tejkaluar kërkesën e thesarit, duke bërë që norma e interesit në nëntor të jetë 1.2% për shumën e 20 milionë eurove.

Edhe për tri ankandet një vjeçare ka pasur ofertim të lartë ndërsa norma e interesit ka shënuar rënie nga 1.98 përqind në tetor në 1.71 përqind në dhjetor.

Këto zhvillime në kuadër të letrave me vlerë në përgjithësi reflektojnë pozicionin e favorshëm të likuiditetit të bankave si dhe orientimin e tyre në drejtim të instrumenteve afatgjata që kanë kthim më të lartë.

Sektori Fiskal²

Të hyrat buxhetore deri në nëntor 2013 shënuan rritje vjetore prej 0.9 përqind duke arritur në 1.20 miliardë euro. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në 1.29 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 4.1 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës deri në nëntor të vitit 2013 regjistroi deficit primar prej 87.6 milionë euro. Ekzekutimi i planit të buxhetit, deri në nëntor 2013, arriti në rreth 82 përqind e planit për vitin 2013, ndërkohë që realizimi i të hyrave buxhetore ishte më i lartë se sa i shpenzimeve duke arritur në rreth 86 përqind të planit për vitin 2013.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore deri në nëntor 2013, është shënuar performancë më e mirë në realizimin e të hyrave vendore të cilat shënuan rritje vjetore prej 9.9 përqind dhe kanë arritur nivelin e 283.0 milionë euro. Rritja e të hyrave vendore është kryesisht rezultat i ngritjes së efikasitetit të ATK-së në mbledhjen e të hyrave dhe lehtësimit të procedurave për deklarimin dhe pagesën e obligimeve tatimore por edhe i rritjes së aktivitetit ekonomik në vend. Në anën tjetër, përkundër rënies së importit, të hyrat e mbledhura në kufi arritën që të mbajnë nivelin e vitit të kaluar prej 755.4 milionë euro.

Shpenzimet qeveritare për investime kapitale deri në nëntor të vitit 2013 shënuan rënie të lehtë vjetore prej 0.3 përqind dhe u realizuan në masën prej 74 përqind të planit për vitin 2013. Përkundër kësaj rënie, shpenzimet kapitale paraqesin kategorinë kryesore në

kuadër të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 35.5 përqind të gjithsej shpenzimeve apo 457.9 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet rrjedhëse i kanë kontribuar pozitivisht rritjes së konsumit të përgjithshëm duke shënuar rritje vjetore prej 7.0 përqind deri në nëntor 2013. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, shpenzimet qeveritare për subvencione dhe transfere kanë shënuar rritje vjetore prej 12.0 përqind, duke arritur në 280.9 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime si dhe shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 10.0 përkatësisht 2.2 përqind duke arritur në 174.6 përkatësisht 381.2 milionë euro.


Rënia e çmimit të naftës mund të reflektojë negativisht në të hyrat buxhetore nga dogana dhe TVSH-ja si rezultat i rënies së vlerës nominale në pagesa për këtë produkt. Rrjedhimisht, në terma nominal, pagesat për këtë produkt mund të jenë më të ulëta. Sidoqoftë, kjo nuk do të ndikojë të hyrat nga akciza pasi që sasia e naftës së importuar pritet të jetë stabile.

² Bilanci Buxhetor i paraqitur në këtë raport është konsistent me definicionin e bilancit primar. Rrjedhimisht, nuk përfshinë kategoritë si: të hyrat nga privatizimi, huamarrjet nga institucionet financiare. Po ashtu, në kalkulime nuk përfshinë edhe pagesat në emër të interesit nga huamarrjet.

Sektori i Jashtëm

Deficiti i llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave të Kosovës është karakterizuar me përmirësim të vazhdueshme gjatë vitit 2013. Vetëm në TM3 2013 është shënuar deficit prej 96.5 milionë euro (32.8 përqind përmirësim krahasuar me TM3 2012).

Figura 30. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2014)

Ky nivel i deficitit të llogarisë rrjedhëse shkaktohet kryesisht nga deficiti tregtar. Sidoqoftë, edhe deficiti tregtar gjatë vitit 2013 është përmirësuar për 3.4 përqind dhe ka arritur vlerën prej 2.2 miliardë euro. Përmirësimi më i madh i bilancit tregtarë është shënuar në TM3 2013 (10.5 përqind).


Eksportet gjatë vitit 2013 kanë shënuar rritje vjetore prej 6.5 përqind dhe kanë arritur në 293.9 milionë euro, ndërsa importet në vitin 2013 u karakterizuan me rënie prej 2.3 përqind dhe kanë arritur në 2.4 miliardë euro. Rrjedhimisht, është përmirësuar shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte nga 11.0 përqind në vitin 2012 në 12.0 përqind në vitin 2013 (figura 30).

Ndër komponentat me ndikim më të madh në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse vazhdon

të jetë niveli i lartë i remitencave që deri në shtator 2013 arritën vlerën prej 454.6 milionë euro ose 4.2 përqind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 31).

Deri në shtator 2013, vlera e IHD-ve arriti në 204.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 14.8 përqind. Kjo rritje e IHD-ve është gjeneruar kryesisht nga fitimi i riinvestuar i kompanive që operojnë në Kosovë, i cili ka shënuar rritje prej 46.1 përqind duke arritur vlerën prej 66.9 milionë euro. Kapitali aksionar, i cili në strukturën e IHD-ve ka pjesëmarrjen më të madhe, ka shënuar rritje prej 8.1 përqind dhe ka arritur vlerën prej 93.0 milionë euro. Investimet tjera, të cilat kryesisht janë kredi ndërmjet kompanive, shënuan rënie prej 4.3 përqind dhe arritën vlerën prej 45.0 milionë euro (figura 32).


Figura 31. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Sa i përket sektorëve, deri në shtator 2013, IHD-të kanë qenë të koncentruara në sektorin e patundshmërisë (33.4 përqind), ndërtimtarisë (17.0 përqind), transportit dhe telekomunikacionit (14.6 përqind), shërbimeve financiare (10.9 përqind), etj.

Figura 32. Struktur e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Ndërsa shtetet të cilat kanë realizuar pjesën më të madhe të investimeve në Kosovë ishin Turqia me 72.8 milionë euro, pasuar nga Zvicra me 31.6 milionë euro, Shqipëria me 18.3 milionë euro, Gjermania 13.4 milionë euro, etj.

Performanca e sektorit të jashtëm të ekonomisë së Kosovës pritet të vazhdojë me trendet pozitive që nënkupton rritje të eksporteve, dërgesave të emigrantëve dhe investimeve të huaja direkte. Kjo si rezultat i pritjeve për performancë më të mirë të sektorit real të ekonomisë së eurozonës dhe vendeve me të cilat Kosova ka aktivitet më të lartë ekonomik.

Citimi i sygjeruar i këtij publikimi:

BQK (2014): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 5 TM4 2013, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2014):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,129>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,163>

ASK (2014):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit, qasur në shkurt 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit, qasur në shkurt 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit, qasur në shkurt 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike, qasur në shkurt 2014: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtise së jashtme, qasur në shkurt 2014: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2014): Metal Prices database, qasur në shkurt 2014.

FAO (2014): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: qasur në shkurt 2014: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2014): Euribor Historical Rates, qasur në shkurt 2014:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2014): World Economic Outlook: qasur në shkurt 2014:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2013/02/weodata/index.aspx>

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2014/update/01/pdf/0114.pdf>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Sektori real 1/		
Çmimet (mesatarja vjetore)	2.5%	1.8%
Çmimet (ndryshimi vjetor)	3.7%	0.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	1,190.7	1,201.0
Shpenzimet (në milionë euro)	1,237.6	1,288.6
Sektori bankar (në milionë euro) 3/		
Asetet e bankave komerciale	2,829.3	3,059.1
Kredi	1,763.4	1,805.8
Depozita	2,279.1	2,449.0
Norma e interesit në kredi	13.4	12.4
Norma e interesit në depozita	3.6	3.4
Hendeku i normës së interesit	9.8	9.0
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/	Shtator 2012	Shtator 2013
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-285.3	-244.1
prej të cilave: importi i mallrave	-1,746.0	-1,703.1
prej të cilave: remitencat	436.2	454.6
Llogaria financiare	63.6	130.4
Investimet e huaj direkte në Kosovë	178.4	204.9
Investimet portfolio, net	-207.0	-227.9
Investimet tjera, net	334.6	244.2
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net	236.6	428.9
Asetet	3,634.0	4,074.3
Detyrimet	3,397.3	3,645.4
Borgji i jashtëm, gjithsej	1,536.9	1,548.2
Borgji i jashtëm privat	1,175.8	1,160.4
Borgji i jashtëm publik	361.2	387.8

Burimi:

1/ ASK (2013).

2/ MF (2013).

3/ BQK (2013).

